



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

## MENAXHIMI I RISKUT

**NOCIONET E NDËRLIDHURA ME RISKUN DHE MUNDËSIA APO  
PROBABILITETI QË DËMI TË NDODHË**

*Prof. Asoc. Dr. Ibish Mazreku*

*Ph.D. Fisnik Morina*



MARS, 2018

# MENAXHIMI I RISKUT

2

- Lënda: Menaxhimi i Riskut
- Viti III-të, Semestri VI, Departamenti: KF
- Statusi i lëndes: Obligative
- Javët mësimore: 15 (2 orë ligjerata, 2 orë ushtrime)
- Mësimdhënes: Prof. Asoc. Dr. Ibish Mazreku  
Ph.D. Fisnik Morina
- Emaili: [ibish.mazreku@unhz.eu](mailto:ibish.mazreku@unhz.eu)  
[fisnik.morina@unhz.eu](mailto:fisnik.morina@unhz.eu)

# NOCIONET E NDËRLIDHURA ME RISKUN

3

□ Para se të kalohet në studimin e mëtejshëm të riskut, duhet të sqarohen disa nocione themelore të cilat janë ngushtë të lidhura me fenomenin e riskut, kështu që mund të thuhet se ato janë elementet e riskut. Ato janë:

1. Pa siguria,
2. Rreziku
3. Hazardi,
4. Shkaku i drejtpërdrejtë,
5. Shansi apo mundësia që dëmi të ndodhë,
6. Ngjarja e dëmshme,
7. Dëmi.

# PASIGURIA

4

- Pasi që shprehja pasiguri shfrytëzohet shpesh në lidhje me riskun, por vjen edhe deri te përzierja e këtyre dy nocioneve.
- Kështu, nocionet “risk” dhe “pasiguri” kanë histori të shkurtë në ekonomi.
- Frank H Knight në vitin 1921 në diskutimin e tij “Risku, Pasiguria dhe Profiti” për herë të parë ka sugjeruar idenë se risku dhe pasiguria mund të jenë relevante për analiza ekonomike.
- Ai ka ndërlidhur fitimet, partneritetet në ndërmarrësi si dhe vet ekzistimin e sistemit të ndërmarrësisë së lire me riskun dhe pasigurinë.

# PASIGURIA

5

- Kur mendohet për pasigurinë zakonisht me këtë nënkuptohet ndonjë dyshim i cili mbështetet në mungesën e njohurisë mbi atë se çka do të ndodhë, apo çka nuk do të ndodhë në të ardhmen, respektivisht ky është dyshimi në mundësinë tonë që të parashikojmë rezultatin e ardhshëm të aktivitetit të tanishëm.
- Ky nocion është e kundërta e nocionit siguri i cili shpreh sigurinë në aspektin e rezultatit të situatës së caktuar, respektivisht nuk ekziston asnjë dyshim.

# PASIGURIA

6

- Ndonjëherë nocion i pasigurisë barazohet me nocionin e riskut, edhe pse pasiguria është vetëm njeri prej faktorëve të riskut. E pasigurt është ngjarja për të cilën nuk dihet se a do të ndodhe, të themi, nga pikëpamja e vdekjes, edhe pse e dimë se do të ndodh, ne nuk e dimë se kur do të ndodhi ajo.
- Kjo është mos ekzistimi i dijes për të ardhmen, respektivisht gjendje e vetëdijes që karakterizohet me dyshim sepse nuk ekziston dija se a do të ndodh diçka në të ardhmen apo nuk do të ndodh.

# Dallimi ndërmjet riskut dhe pasigurisë

7

## RISKU

Natyrës objektive

I matshëm

Mund të përcaktohet  
probabiliteti dhe intensiteti i tij

## PASIGURIA

Natyrës subjektive

I pa matshëm

Nuk ka karakter absolut

Shprehje psikologjike mosdijes

# PASIGURIA

8

- Nëse për shembull, e paramendojmë pasigurinë si mjegullën e cila alpinistit ia pamundëson të shoh rrugët malore, ai sigurisht do të konkludoi se më mirë është të pritët që mjegulla të ngrihet se sa të vazhdoi nëpër mjegull në rrugën të cilën nuk e njeh.
- Kur mjegulla të ngrihet ai sheh se rruga nuk është e lehtë dhe se ekzistojnë vende të rrezikshme, por tani, pasi qëe ka pasqyrën e qartë të rrugës, mund të vendos që të vazhdoi me ngritjen në male.
- Këtu do të thotë se risku themelor (rruga e rrezikshme) nuk është zvogëluar, e as që është zvogëluar frika e alpinistit ndaj riskut, por vendimi i tij është proporcionale me riskun ekzistues.



# PASIGURIA

9

Ngjarja e ardhshme	Probabilitëti i ngjarjes (p)
I sigurt	$P = 1$
I rrezikshëm	$0 < p < 1$
E pamundshme	$P = 0$
I pasigurt	$P = e$ panjohur

# PASIGURIA

10

- Shpenzimet më të dukshme të riskut janë shpenzimet e dëmit, respektivisht shpenzimet e bëra për shkak të shkatërrimit të pasurisë, lëndimit të njerëzve apo shpenzimet e seancave gjyqësore për shkak të përgjegjësisë.
- Mirëpo ekzistojnë edhe shpenzimet tjera të riskut të cilat nuk janë aq të dukshme, e këto janë shpenzimet e lidhura për pasigurinë.
- Të aktivitetet komplekse si është për shembull, ndonjë aktivitet afariste, disa persona janë shumë të kujdesshme, deri sa të tjerët janë shumë agresiv, në veresi të asaj se si individi e sheh riskun në aktivitetin e dhënë.

# Nivelet e pasigurisë

11

Niveli i pasigurisë	Karakteristikat	Shembuj
Nuk ka pasiguri	Rezultati mund të vërtëtohet në mënyrë shumë precize	Ligjet e fizikes, shkencat natyrore
Niveli – 1 (pasiguria objektive)	Rezultati identifikohet ndërsa probabilitëti dihet	Lojërat e fatit, letrat, hedhja e kubit
Niveli – 2 (pasiguria subjektive)	Rezultatët identifikohen por probabilitëtit janë të panjohura	Zjarri, fatkeqësia automobilistike, shumë investime
Niveli 3	Rezultatët nuk identifikohen plotësisht, ndërsa probabilitëtit janë të panjohura	Hulumtimet e gjithësisë, hulumtimet gjenetike

# PASIGURIA

- Në këto projekte, sikurse edhe të shumë hulumtime shkencore, natyra e të gjitha rezultateve shpesh nuk mund të identifikohet para se të fillohet me zbatimin e projektit. Risqet më të rëndësishme me të cilët ballafaqohen organizatat janë të niveli 2 dhe 3.
- Organizata duhet të mbështetet në metoda të cilat nuk janë shkencore që të vlerësoi dhe kontrolloi risqet të cilat gjenden në këto nivele të pasigurisë.
- Niveli i pasigurisë i llojit të caktuar të riskut mund të varet edhe nga entiteti i cili ballafaqohet me riskun. Për shembull, siguruesit apo qeverisë mund ti duket se risku nga tërmeti ka nivelin e pasigurisë 2, deri sa individit mund ti duket se ai risk i takon nivelit 3.

# RREZIKU

13

- Rreziku dallon nga nocioni i riskut dhe definohet si shkak potencial i ndodhjes së dëmit apo humbjes.
- Rreziku është diçka që mund të shkaktojë humbjen e ndonjë vlere, kur ajo vlerë i nënshtrohet ndikimit të rrezikut të dhënë.
- Rreziku (si p.sh zjarri, uragani, sulmi në zemër, aktiviteti kriminal etj.) mund të veprojnë të pavarur apo në mënyrë kumulative së bashku me rreziqe tjera.
- Nëse ndonjë shtëpi digjet për shkak të zjarrit, rrezik apo shkak i dëmit është flaka. Nëse një automobil dëmtohet në aksident me automobilin tjetër, ndeshja është rreziku apo shkaktar i dëmit.

# RREZIKU

- Disa rreziqe të rëndomta të cilat nxisin dëmtimin e pasurisë apo humbjen e saj përfshijnë flakën, zjarrin, ortelet, uraganët, breshërinë, tornadon, tërmetët, hajnin dhe vjedhjen.
- Policat e sigurimit sigurojnë mbrojtjen financiare nga humbjet të cilat janë nxitur nga rreziqet e ndryshme, të cilat zakonisht theksohen në policë.
- Rreziqet mund të jenë të natyrës (ngjarjet ekstreme në natyrë si janë tërmetët dhe vërshimet), biologjike (sëmundjet ngjitëse, modifikimi gjenetik) dhe të natyrës industriale (materialet e dëmshme nga proceset prodhuese).

# HAZARDI

15

- Hazardi është rrethana e cila krijon apo rrit rrezikun dhe riskun, respektivisht probabilitetin që të vjen deri të ngjarja e dëmshme dhe humbja, respektivisht është rrethanë e cila e rrit qoftë shpeshtësinë apo seriozitëtin e dëmit.
- Shembull i hazardit për shembull është ruajtja e kantës me benzinë në garazh, ndriçimi i dobët i rrugës në zonën ku ndodhin vjedhjet, pirja e duhanit është hazard i cili e rrit rrezikun nga kanceri i mushkërive etj.
- Vetvetiu asnjëra nga këto rrethana nuk do shkaktoi dëmin. Mirëpo, ato dëm që ndodh dukshëm do ta rrisin.

# HAZARDI

16

- Në shikim të parë duket se ky nocion nënkupton ngjashëm sikurse “risku”, por dallimi kryesorë është në atë se hazardi është veti e cila nuk varet nga frekuenca apo pasoja.
- Ajo mund ti rritë, por nuk varet nga ato, kurse rreziku është shprehje kualitative dhe kuantitative e humbjes së mundshme, shprehje që në vete përfshinë edhe probabilitetin edhe pasojat.
- Risqet mund të kontrollohen, të zvogëlohen apo të minimizohen. Hazardi, respektivisht rreziku indirekt ose ekziston ose nuk ekziston, ai nuk mundet as të kontrollohet apo të minimizohet.



# HAZARDI FIZIK

17

- **Hazard** fizik është kusht fizik i cili është pasoj e karakteristikave materiale të ndonjë objekti, me të cilin rast ato karakteristika materiale e rritin riskun, respektivisht shansin që ndonjë ngjarje të ndodhe.
- Shembull i hazardit fizik është rruga e rrëshqitshme e cila e rrit shansin që të vjen deri të fatkeqësia automobilistike e cila është pasojë e ndeshjes i cili në këtë rast paraqet rrezikshmëri.

# HAZARDI MORAL

18

- **Hazardi moral** është rritje e probabilitetit të ndodhjes së dëmit dhe humbjes për shkak të qëllimeve dhe të qasjeve të pandershme dhe të pamoralshme të personave të siguruar.
- Shembuj të hazardit moral janë aksidentët e montuara që të përfitohet sigurimit, dërgimi i kërkesave të rrejshme, rritja e shumës së kërkesës për zhdëmtim dhe djegia e qëllimshme e mallit të pahitur i cili është i siguruar.
- Për shembull, nëse dikush e kalle ndërtësën që ta paguaj sigurimin, zjarri do nxitë dëmin, por hazardi moral është përgjegjës për rritjen e frekuencës së dëmit.

# HAZARDI PSIKOLOGJIK

- **Hazardi psikologjik** është pakujdesi apo indiferenca ndaj dëmit për shkak të ekzistimit të sigurimit.
- Disa të siguruar janë indiferent apo të pakujdesshëm ndaj dëmit, sepse e kanë sigurimin.
- Shembuj të këtyre lloje të rreziqeve përfshijnë lënjen e çelësave të veturës në veturën e ndezur dhe të pambyllur dhe me vetë këtë i rrit shanset e hajnave, lënja e dyerve të pambyllura e lehtëson hyrjen e rrëmbyesit, dhe ndërrimin e befasueshëm të drejtimit në udhëkryqet e ngushta të autostradës pa dhënë fare sinjal.
- Sjelljet e pakujdesshme si ishte kjo rritin shanset që të ndodhë dëmi.


# HAZARDI I PËRGJEGJISISË LIGJORE

20

- **Hazardi i përgjegjesisë ligjore** përfshinë sistemin juridik apo rregulloret të cilat mund ta rrisin frekuencën apo intensitetin e dëmit, si janë vendimet e gjyqeve të cilat janë negative në raport me shkaktarët, shumat e larta të kompensimit të dëmeve të vendimet për përgjegjësit etj.
- Është e mundur që diçka të jetë edhe rrezik edhe hazard. Për shembull, sëmundja është rrezik e cila shkakton dëme personale, por njëkohësisht është edhe hazard, sepse e rritë mundësinë e rritjes së mundësisë së vdekjes së parakohshme.

# Ndikimi i hazardit në rrezik dhe humbje

Foto II-5. Ndikimi i hazardit në rrezik dhe humbje



# SHKAKU I DREJTPËRDREJTË

22

- **Shkaku i drejtpërdrejtë** i dëmit është koncept shumë i rëndësishëm në sigurimin e pasurisë.
- Në terminologjinë e sigurimeve shkaktari i drejtpërdrejtë i dëmit është rreziku i parë në zinxhirin e ngjarjeve të cilat e kanë shkaktuar dëmin. Ky është hap pa të cilin dëmi nuk do të kishte ndodhur.
- Për shembull, nëse rrufeja e djege ndonjë shtëpi, ashtu që automjeti zjarrfikës i cili është thirrur për ta shuar zjarrin bën ndeshje me automjetin tjetër dikush mund të kërkojë që rrufeja e cila ka qenë e larguar nga automjeti disa kilometra të jetë shkak i drejtpërdrejtë i ndeshjes.

# MUNDËSIA APO PROBABILITETI SE DËMI TË NDODHË

23

- **Mundësia që ndonjë dëme të ndodhë** definohet si probabilitet i ndodhjes së ngjarjes së dëmshme dhe mund të paraqitet në mënyrë objektive dhe subjektive. Ky probabilitet i ndodhjes së dëmit krijon domosdoshmërinë e nevojës për sigurim. Kështu që, sikur të mos ekzistoi kjo mundësi nuk do të ekzistonte edhe nevoja për sigurim.
- Vlerësim objektiv i probabilitetit ka të bëjë me gjatësinë relative të shpeshtësisë të një ngjarje e cila bazohet në supozimin e një numri të pakufizuar të vrojtimeve dhe në mos ekzistimin e ndryshimit në kushtet e dhëna.

# MUNDËSIA APO PROBABILITETI SE DËMI TË NDODHË

24

- Ky probabilitet objektiv mund të përcaktohet në dy mënyra.
- E para, ato mund të përcaktohen përmes **rezonimit deduktiv**, çka do të thotë se përcaktohet në bazë të përvojës dhe ato quhen probabilitet apriori.
- Për shembull, probabiliteti se do të fitohet kokë nga hedhja në ajër të monedhës të balancuar në mënyrë përfekt është  $\frac{1}{2}$ , sepse ka dy anë, e vetëm njëra është kokë.
- Në të njëjtën mënyrë, probabiliteti se do të fitohet gjashtë nga një hedhje e kubit është  $\frac{1}{6}$ , sepse kubi ka gjashtë anë e vetëm një anë ka gjashtë pikë.



# MUNDËSIA APO PROBABILITETI SE DËMI TË NDODHË

25

- E dyta, probabiliteti objektiv mund të përcaktohet edhe përmes **rezonimit induktiv**.
- Për shembull, probabiliteti se personi që ka 21 vite do të vdes para personit që ka 26 vite nuk mund të deduktohen në mënyrë të logjikshme.
- Mirëpo, përmes analizës së kujdesshme të të dhënave ekzistuese e cila ka të bëjë me numrin e rasteve të vdekjes, siguruesi i jetes mund të vlerësoi probabilitetin e rezultatit të vdekjeve dhe të shesë policën pesëvjeçare të sigurimit të jetës personit që i ka 25 vite.

# MUNDËSIA APO PROBABILITETI SE DËMI TË NDODHË

26

- **Vlerësimi subjektiv i probabilitetit** është vlerësim subjektiv i individit mbi mundësitë që ndonjë dëm të ndodhë.
- Vlerësimi subjektiv i mundësive nuk do të thotë që të përputhet me atë objektive.
- Për shembull, njerëzit të cilët blejnë një tiketë lotarie në ditëlindjen e vet mund të besojnë se ajo është ditë e fatit dhe të vlerësojnë shanset për fitim.

# NGJARJA E DËMSHME

- Definicioni i nocionit “**ngjarje e dëmshme**” është e ndryshme ne varësi nga bazat nisëse dhe qëllimi i precizimit të saj.
- Në marrëdhëniet kontraktuale të sigurimit me ngjarje të dëmshme, respektivisht “rastin e siguruar” nënkuptohet ngjarja të cilën e ka shkaktuar risku i siguruar.
- Që risku të përfshihet me sigurim ai duhet të jetë i ardhshëm, i pasigurtë dhe i pavarur nga vullneti i të sigurvearit apo kontraktuesit të sigurimit, ndërsa shfaqja e tij paraqet realizimin e rrezikshmërisë e cila është e përfshirë në kontratën e sigurimit.

# NGJARJA E DËMSHME


- Në sistemet industriale ngjarja e dëmshme zakonisht përfshinë lirim të materieve të dëmshme (kimikali, radioaktivitetin) apo nivelin e dëmshëm të energjisë nga objektet industriale apo të paisjeve për ambientin jetësor.
- Kjo zakonisht ngjanë në formë të eksplozionit, zjarrit, shpërndarjes, derdhjes apo mbeturinave.
- Deri të këto ngjarje të dëmshme mund të vjen si pasojë e faktorëve të cilët janë të brendshëm në disa sisteme industriale (dmth përmes gabimit teknik), apo si pasojë e faktorëve të jashtëm (ngjarjet ekstreme në natyrë).

# NGJARJA E DËMSHME

- Shkaqet e ngjarjeve të dëmshme mund ti grupojmë në dy grupe (foto II -6):
  1. Sigurisht të parashikueshme, të cilat gjenden në lëshimet e aplikimeve praktike, ligjeve dhe standardeve, të masave të planifikuara të mbrojtjes preventive dhe,
  2. Sigurisht të paparashikueshme, format paraqitëse e të cilave nuk mund ti parashikojmë në kohë reale.


# NGJARJA E DËMSHME

30



# Format e paraqitjes se ngjarjeve të dëmshme

31



# NDIKIMET THEMELORE NË PARAQITJEN E NGJARJES SË DËMSHME


32

- **Faktorët e rastësishëm** që ndikojnë në lajmërimin e ngjarjeve të dëmshme mund të analizohen dhe të klasifikohen në mënyra të ndryshme, varësisht nga qasja apo qëllimit më i afërt i vrojtimit. Për veprim efektiv preventiv, respektivisht nga pikëpamja e metodës së inxhinjeringut preventiv, dy nivele të analizës kanë rëndësi të veçantë.
- **I pari** ka të bëjë me kornizën e gjerë të vrojtimit, e i cila përfshinë të gjithë faktorët me ndikim, ndërsa **i dyti** në analizën e ndikimeve të cilat kryesisht janë të lidhura për vet sistemin teknik.



# NDIKIMET THEMELORE NË PARAQITJEN E NGJARJES SË DËMSHME

33



# NDIKIMET THEMELORE NË PARAQITJEN E NGJARJES SË DËMSHME

34

- **Faktori njeri** përfshinë të gjithë njerëzit të cilët në cilën do mënyrë, drejtpërdrejtë apo indirekt, ndikojnë në punën e sistemit, respektivisht në paraqitjen e ngjarjes së dëmshme, duke filluar nga projektantët apo konstruktorët, përmes inxhinierëve dhe punëtorëve në prodhim, punëtorëve në mirëmbajtje në infrastrukturë deri të udhëheqësit, organet kontrolluese dhe mbikëqyrëse, personat e paautorizuar apo të rastësishëm (p.sh këmbësorëve dhe pjesëmarrjeve të tjerë në komunikacion) etj.

# NDIKIMET THEMELORE NË PARAQITJEN E NGJARJES SË DËMSHME

35

- **Faktori i sistemit teknik** përfshinë jo vetëm makinën dhe objektin i cili është objekt i vrojtimit, por edhe të gjithë elementët e infrastrukturës dhe mbështëtjes, si janë sistemet e furnizimit me energji elektrike, ujë, materialet tjera shpenzues, rrugët, komunikimet dhe objektet tjera infrastrukturore, si dhe sistemi i qeverisjes automatike apo formave të tjera të qeverisjes me punën e sistemit të vrojtuar teknik.
- **Faktori i klimës** krahas faktorëve klimatik – meteorologjik, i përfshinë edhe të gjithë elementët të cilat e krijojnë ambientin në të cilin punon sistemi teknik i vrojtuar e që kanë të bëjnë me rregullativen juridike dhe të tjera, ndikimin e tregut dhe të konkurrencës, kufizimet financiare – matëriale etj.

# NDIKIMET THEMELORE NË PARAQITJEN E NGJARJES SË DËMSHME

36

- **Faktori i konstruksionit/projektit** përfshinë jo vetëm konstruksionet, dokumentacionin projektues apo të punëtorisë, por edhe dokumentacionin përcjellës (rregullat dhe standardet interne për përpunimin termik, mbrojtjes sipërfaqësore etj.) si dhe udhëzimet për udhëheqje dhe mirëmbajtje, rregullat dhe procedurat për ç’regjistrim dhe reciklazhe e ngjashëm.
- **Faktori prodhim** përfshinë të gjitha elementët teknologjike të procesit të prodhimit, duke përfshi sistemin e menaxhimit me kualitetin, testimet mesfazore dhe përfundimtare dhe vërtetimin e kualitetit, kontrollin hyrës të lëndëve të para dhe gjysëmfabrikatëve, standardet e prodhimit dhe teknologjike.

# NDIKIMET THEMELORE NË PARAQITJEN E NGJARJES SË DËMSHME

- **Faktori i mirëmbajtjes** përfshinë të gjitha elementët e sistemit të mirëmbajtjes dhe atë si nga aspekti i konceptimit (mirëmbajta preventive dhe korrektive), teknologjive (procedurat e caktuara) dhe organizimit (niveli i mirëmbajtjes dhe autorizimet).
- **Faktori i shfrytëzimit** përveç mënyrës së punës, respektivisht disiplinës në zbatimin e procedurave të kërkuara për shfrytëzimin e sistemit teknik, përfshinë edhe elemente të infrastrukturës (vendit përgatitës, garazheve, sistemit për mbrojtje nga zjarri dhe mbrojtje në punë, rojet etj.).
- **Faktori i mbështetjes logjistike** përfshinë të gjitha elementet të sigurisë integrale teknike të cilat janë të domosdoshme për punë dhe mirëmbajta të sistemit të vrojtuar.

# DËMI

38


- **Dëmi** është humbje (në gjuhën angleze “loss”), në kuptimin më të gjerë tregon se dikush ka mbetur pa asgjë e që e ka poseduar me parë. Në teorinë juridike dëmi zakonisht definohet si shkaktim të lëndimit të së drejtës apo interesit subjektiv të dikujt përmes veprimit të dëmshëm.
- Dëmi mund të jetë **material dhe jomaterial**.
- **Dëmi material** mund të jetë dëmi i vërtetë (vlera e zvogëluar e pasurisë ekzistuese) dhe fitimi i porealizuar (do të thotë rritja e porealizuar e pasurisë e cila përndryshe do të realizohej sikur kushtet të ishin normale).
- **Dëmi jomaterial** ndodhë si pasojë e lëndimit të ndonjë karakteristike individuale të ndonjë personi (shëndeti, pamja fizike etj.).

# Dallimet e kuptimit të nocionit “dëme”

39

NOCIONI JURIDIK	NOCIONI NË SIGURIME
Dëmi i ndodhur nga lëndimi i interesave të njohura juridike	Edhe dëmet që në aspektin juridik janë relevante, p.sh. ngjarjet natyrore (uragani, vërshimet, breshërit etj)
Vetëm dëmet që u kanë ndodhur të tjerëve	Edhe dëmet që i kanë ndodhur vetë të siguruarit/shfrytëzuesit të sigurimit
Dëmet që janë pasojë e një veprimi të dëmshëm	Dëmet që janë pasojë e realizimit të rastit të siguruar
Dëme "të shkaktuara"	Dëmet e "rrezikshme", ato që nuk varen nga vullneti ekskluziv i të siguruarit
Dëme të pranuar juridikisht	Dëmet e kontraktuara apo ato të cilat nuk janë përjashtuar

# NDARJA E DËMEVE





# DËMI

- Nëse, sipas definicionit të rrezikut, dëmet i definojmë si realizim të shmangies së rastësishme nga e pritura, atëherë risku i shmangieve të rastësishme mund të manifestohet në dy mënyra:
1. Mundësi e ndodhjes së dëmit të madhe në një rrezik, dhe
  2. Akumulimit të numrit të madh të dëmeve të vogla dhe të mesme, si rezultat e veprimit të fuqive elementare.

# DËMET TOTALE DHE TË PJESËSHME

42

- Në thelb ekzistojnë dy kategori dëmsh dhe ato:
  - 1. Dëmet totale, dhe
  - 2. Dëmet e pjesshme.
- Të dëmet totale kemi të bëjmë me humbjen e plotë në objektin e siguruar, respektivisht shkatërrimin apo humbjen e objektit të sigurimit.
- Me nocionin dëme të pjesshme nënkuptojmë, kur me realizimin e riskut të siguruar vjen deri të humbja e plotë e një pjesë të objektit të sigurimit, respektivisht deri të dëmtimi i pjesshëm objektit të siguruar.

# DËMET DIREKTE DHE INDIREKTE

43

- **Dëmi i drejtpërdrejtë** të sigurimet jo jetë është ai dëm i cili ka ndodhur në vet objektin e siguruar. Për shembull, rrufeja mund të godet në ndërtesë dhe të shkaktoi zjarr i cili ka shkatërruar konstruksionin e ndërtesës, inventarin, mallin dhe pajisjet që janë gjendur në të.
- Nëse dëmi në pasuri është i madh, pronari i këtij biznesi mund të jetë i detyruar që përkohësisht ta ndërpret afarizmin, me të cilin rast përveç shpenzimeve të riparimit apo ndërrimit të objektit të dëmtuar vjen edhe deri të humbja e profitit.

# Ju Faleminderit për vëmendje !

44

□ SUKSESE !

